



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 184 prot.

Kamëz, më 18, 12.2020

V E N D I M

Nr. 158 Datë 18, 12.2020

P Ë R

**"MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE GJATË VITIT 2021 PËR FAMILJET QË NUK JANË PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT DHE QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE"**

**Këshilli Bashkiak Kamëz** i mbledhur sot më **18.12.2020** në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.147 Datë 14.12.2020**, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 21 të Ligjit nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë, Kreut IV, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", dhe VKB nr. 85, datë 17.07.2020 "Për miratimin e limiteve të PBA për vitet 2021, 2022, 2023, **Këshilli Bashkiak Kamëz :**

V E N D O S I :

1. Miratimin e kriterëve për dhënie të ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, duke përdorur deri në 6 % nga fondin e kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike, si më poshtë vijon :
  - Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh por që jetojnë në kushte të varfërisë ekstreme në banesa të papërshtatshme (baraka, objekte të modifikuara për banim si ish-stallat, magazinat etj.).
  - Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh, që janë të varfëra dhe kanë fëmijet në shkollë të moshes nën 18 vjeç dhe nuk kanë anetare të tjerë moshë në punë.
  - Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh, që janë të varfëra dhe kanë fëmijet nën moshë në punë dhe njeri nga prinderit është person me aftësi të kufizuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

- Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh, që janë të varfëra dhe perbehen nga të moshuar të vetmuar dhe pa kujdestari ose gra me probleme të dhunes në familje.
  - Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit për mungesë pikësh por janë të varfëra, me k/familjar nënën me fëmijë të mitur, që merr një pension minimal për jetesë.
  - Familjet me pak anëtarë që refuzohen nga sistemi i pikëzimit, të cilat janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe pa të ardhura, familje me kryefamiljarë në burg dhe fëmijë të vegjël.
  - Familjet që refuzohen nga sistemi i pikëzimit, të cilat disponojnë motor apo ciklomotor, por që janë familje në kushte të varfërisë ekstreme dhe/ ose kanë probleme të mëdha shëndetësore.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETARE  
MERITA PRENGA

